



Buletin informativ

Procedurat e fundvitit

Afati i fundit për dorëzimin e Pasqyrave Financiare, Tatimit mbi Fitimin dhe Njoftimit Vjetor të Transaksioneve të Kontrolluara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 po afron. Në mënyrë që të jeni në përputhje me legjislacionin fiskal dhe atë kontabël shqiptar¹, ekspertët e Mazars dëshirojnë të sjellin në vëmendjen tuaj çështjet e mëposhtme:

❖ **Tatimi i mbajtur në burim**

Shoqëria duhet të paguajë brenda 20 janarit 2021 tatimin në burim në lidhje me transaksionet e mëposhtme, të cilat do të regjistrohen në librat kontabël të 2020:

- i. Për shërbimet e marra nga shoqëri të huaja të paregjistruara në autoritetet tatimore shqiptare (pavarësisht nëse ata kanë caktuar një përfaqësues tatimor për qëllime të TVSH-së në Shqipëri ose jo) shoqëria duhet të paguajë brenda fundvitit tatimin në burim te autoritetet tatimore shqiptare, në mënyrë që shpenzimet përkatëse të konsiderohen të zbritshme për qëllime të Tatimit mbi Fitimin (TF). Ky rregull është i zbatueshëm pavarësisht nga pagesës apo jo të faturës përkatëse. Në rast se ekziston një Marrëveshje për shmangien e taksimit të dyfishtë (MSHTD) me vendin e rezidencës së shoqërisë së huaj, ju lutemi referohuni dispozitave të saj dhe sigurohuni që të ndiqni procedurat e shmangies me autoritetet tatimore shqiptare.
- ii. Interesat dhe honoraret që i paguhen shoqërive të huaja të paregjistruara në autoritetet tatimore shqiptare duhet t'i nënshtrohen një analize në rast se ekziston një MSHTD me shtetin ku është vendbanimi i shoqërisë së huaj. Përqindja e tatimit për t'u mbajtur në burim duhet të jetë ajo e specifikuar në dispozitat e MSHTD. Në të gjitha rastet kur interesat dhe honoraret konsiderohen të përjashtuara nga tatimi në burim në Shqipëri ose i nënshtrohen një norme të reduktuar të tatimit në burim, ju lutemi sigurohuni që gjithsesi të ndiqni procedurat e shmangies me autoritetet tatimore shqiptare.

❖ **Aplikimi i "Auto-faturës" (mekanizmi i reverse-charge) dhe "Fatura e lëshuar nga blerësi"**

Për të gjitha shërbimet e ofruara nga shoqëri të huaja, individë të huaj si dhe individë vendas të paregjistruar (dhe që nuk janë të detyruar të regjistrohen) pranë autoriteteve tatimore shqiptare, tatimpaguesi duhet të aplikojë autofaturën (reverse charge) dhe procedurën e "faturës së lëshuar nga blerësi".

Në rast se shoqëria nuk ka përmbushur këto kërkesa gjatë vitit, legjislacioni shqiptar parashikon që tatimpaguesit të kenë mundësinë të paraqesin deklaratat tatimore të rishikuara brenda 36 muajve nga data e dorëzimit të deklaratës fillestare të tatimit.

Këto procedura duhet të ndiqen edhe për ato shërbime për të cilat është rënë dakord të faturohen brenda vitit 2020, por faturat fizike nuk kanë mbërritur ende. Në rast mosndjekje të procedurave të mësipërme, shpenzimet e kryera për këto shërbime do të konsiderohen si të pazbritshme për qëllimet e TF.

¹ Ky buletin informativ nuk ka për qëllim të japi informacion të detajuar në lidhje me rakordimet kontabël që kryhen në fund të vitit për qëllime të përgatitjes së pasqyrave financiare.

❖ **Inventari në fundvit**

Numërimi dhe vlerësimi fizik duhet të kryhet dhe dokumentohet për qëllime tatimore, në lidhje me gjendjen / situatën më 31 dhjetor 2020 të:

- i. Inventarit fizik
- ii. Asteve fikse

Ju lutemi merrni parasysh të ndiqni dispozitat e ligjeve përkatëse të TVSH-së dhe Tatimit mbi të Ardhurat, në rast të inventarit të dëmtuar ose asetëve të nxjerra jashtë përdorimit.

❖ **Numërimi i parave në dorë në fundvit**

Numërimi i parave në dorë duhet të kryhet dhe dokumentohet për të gjithë shumën e parave në lekë dhe monedha të huaja më 31 dhjetor 2020.

❖ **Deklaratat bankare në fundvit**

Për qëllim të rakordimit të gjendjeve bankare të paraqitura në pasqyrat financiare, ne do të sugjeronim që të dërgohen letra konfirmimi në bankat me të cilat shoqëria bashkëpunon, për konfirmimin e gjendjeve të fundvitit për secilën llogari bankare.

❖ **Konfirmimi i gjendjes së llogarive të arkëtueshme dhe pagueshme të klientëve dhe furnitorëve në fundvit**

Letrat e konfirmimit duhet t'u dërgohen furnitorëve dhe klientëve për të rakorduar balancat e tyre me tuajat në 31 Dhjetor 2020, në mënyrë që të sigurohet saktësia e vlerave që do të paraqiten në pasqyrat financiare.

Ju lutemi merrni parasysh të ndiqni dispozitat e ligjeve përkatëse të TVSH-së dhe Tatimit mbi të Ardhurat, në rast mos rakordimi të balancave apo humbjeve të pritshme.

❖ **Konfirmimi i pozicionit tatimor të fundvitit me sistemin e taksave**

Me mbylljen e deklaratave të muajit dhjetor, do të sygjeronim të nxirrej një ekstrat i librit të përgjithshëm të llogarive në sistemin e taksave (efiling) të Shoqërisë. Kjo situatë duhet të mbulojë të gjitha llojet e taksave: TVSH, TF, Kontributet për Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore dhe Tatimin mbi të Ardhurat Personale. Ne ju rekomandojmë të rakordoni këto balanca me regjistrimet kontabël të Shoqërisë për të identifikuar çdo mospërputhje të mundshme. Diferencat e tilla (nëse ka) duhet të ndiqen dhe sqarohen me inspektorin tuaj tatimor.

❖ **Transaksionet me palët e lidhura**

Në rast se transaksionet e kontrolluara të kryera me palët tuaja të lidhura janë mbi 50 milion lekë (duke marrë parasysh të gjitha transaksionet përfshirë gjendjet e huave), ju duhet të paraqisni tek autoritetet tatimore njoftimin vjetor të transaksioneve të kontrolluara brenda 31 marsit.

Nëse analiza e transferimit të çmimit konkludon se çmimet e aplikuara ndërmjet palëve të lidhura nuk janë në përputhje me parimin e tregut, duhet të kryhet një rregullim në mënyrë që të ulen shpenzimet e njohura ose të rriten të ardhurat e tatueshme. Ne sugjerojmë të bëni një analizë të tillë përpara se të dorëzoni deklaratën e Tatimit mbi Fitimin.

❖ Raporti i audituesit të pavarur

Ju rikujtojmë se kërkohet një raport i pavarur auditimi, nëse shoqëria juaj plotëson një nga kushtet e mëposhtme:

- i. Përgatit pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
- ii. Është një shoqëri aksionare pavarësisht kornizës raportuese;
- iii. Është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar që raporton bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit kur, në fund të periudhës kontabël, për dy vite rresht, ka tejkalluar dy nga tre treguesit e mëposhtëm:
 - a. Totali i aktiveve të bilancit, në fund të vitit ushtrimor, arrin ose tejkalon shumën prej 50 milion lekësh;
 - b. Shuma e të ardhurave nga aktiviteti ekonomik (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose tejkalon shumën prej 100 milion lekësh;
 - c. Ka mesatarisht, 30 punonjës gjatë periudhës raportuese

❖ Kërkesa të tjera për raportim

Që prej vitit të kaluar, krahas pasqyrave financiare kërkohen disa raporte shtesë:

- i. **Raporti i ecurisë së veprimtarisë** - njësitet ekonomike duhet të përgatisin raportin e ecurisë së veprimtarisë, i cili përmes një analize gjithëpërfshirëse, paraqet drejt zhvillimin dhe performancën e njësisë, shoqëruar me një përshkrim të risqeve dhe pasigurive kryesore, me të cilat njësia mund të përballet.
- ii. **Raporti jo-financiar** - Njësitë e mëdha ekonomike, të cilat janë shoqëri me interes publik ,numri mesatar i të punësuarve të së cilave tejkalon 500, gjatë periudhës raportuese, duhet të përfshijnë në raportin e ecurisë së veprimtarisë, një raport jo-financiar, i cili përfshin informacionin e nevojshëm për një kuptim më të mirë të zhvillimit, performancës, pozicionit dhe ndikimit të vetë entitetit në mjedis, çështje sociale dhe punësim, respektim të të drejtave të njeriut, çështjet anti-korrupsion dhe ryshfetet.
- iii. **Raporti i drejtimit të brendshëm** - Njësitë e interesit publik duhet të përfshijnë në raportin e ecurisë së veprimtarisë raportin e drejtimit të brendshëm të njësisë.

SHËNIM:

Për të gjithë ata klientë për të cilët Mazars në Shqipëri ofron shërbime të taksave, kontabilitetit dhe transferimit të çmimit, ky buletin informativ është vetëm për qëllime njoftimi.

Ky buletin informativ është vetëm për qëllime informimi dhe nuk ka si objekt dhënien e një konsulence profesionale të dedikuar në lëmin fiskal.

KONTAKT

MAZARS ALBANIA & KOSOVO

Për më shumë detaje mbi çështjet e mësipërme ose çështje të tjera në fushën fiskale, ju lutemi kontaktoni:

Teit GJINI

Managing Partner
teit.gjini@mazars.al

Erinda XHAFERRAJ

Head of Tax Advisory Services
erinda.xhaferraj@mazars.al

Adresa

Rr. Emin Duraku, Pall. Binjaket, Nr.5,
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2222 889
E-mail: info@mazars.al